



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, Datë: 25.01.2019  
Nr.020-1505/10

**Për: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit**  
**Burim Gerguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit**

**Lënda: Shkresë përcjellëse**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, **Vendimin Nr. 203** për aprovimin e kërkesës nga DPUKP, për lirimin nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore për të gjithë përfituesit e skemës sociale dhe për donator, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit dhe nënshkuara nga Kryesuesi i KK të Obiliqit, më qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 04.01.2019, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

MAPL, kërkon nga Komuna që zyrtarisht të njoftohet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e këtij akti.

Bashkangjitur gjeni Raportin nga MMPH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

**Rozafa Ukimeraj**  
Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR  
 MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Mbi Org: 02  
 Org. Adresa: \_\_\_\_\_  
 Org. Udh: \_\_\_\_\_

Nr. Prot: 57-2/19  
 Prot. Nr: \_\_\_\_\_

D. i hapjes: 02  
 D. i kthimit: \_\_\_\_\_  
 M. i hapjes: \_\_\_\_\_

Data: 25.01.19  
 Data: \_\_\_\_\_  
 Data: \_\_\_\_\_

Prishtine / e



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

ZYRESE E DLAZNA-INCOMING  
 REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA

Adresa e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Adresa e Lokalne Samouprave i Administracije  
 Address of Local Government Administration

25.01.2019

Shifra e Dokumentit	Pr. Lëndës	Shporta	Vlera
-VI-	020-1505/10		

Për:	Ivan Todosijeviq, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Ce:	Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Përmes:	Fatmir Matoshi, Ministër i MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
Nga:	Vlora Osaj, u.d.Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendimi i Komunës së Obiliqit

I nderuar Ministër,  
 I nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi , Nr.203 për aprovimin e kërkesës nga DPUKP. për lirimin nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore për të gjithë përfituesit e skemës sociale dhe për donatorë , i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliçit i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliçit.

I miratuar me datë:31.12.2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 04.01.2019

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 04.01.2019

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**. Mos pajtueshmëri të aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi Nr.203, i miratuar me datë 31.12.2018, nga Kuvendi Komunal Malishevë  Preambula (hyrja e vendimit)	1.Preambulës së vendimit i mungon baza ligjore, në bazë të të cilit mund të lejohet lirimi nga pagesa e taksës dhe tarifës.
2		

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i propozon MAPL-së që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.